



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0922**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE N.N.P. "Euro Construction", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc" me numër të prokurimit 632-23-4357-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, më 14/02/2024, mori këtë:

## Vendim

**1. Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e N.N.P. "Euro Construction" me nr. 2023/0922, e datës 20/11/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc", me numër të prokurimit 632-23-4357-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës.

**2. Mbetët në fuqi** vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc", me numër të prokurimit 632-23-4357-5-2-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 04.05.2023 Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc", me numër të prokurimit 632-23-4357-5-2-1. Me datën 30.10.2023 AK, ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës të

operatorit ekonomik “Triangle” Sh. P. K.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës 399,969.82€.

Me 06.11.2023, OE N.N.P “Euro Construction” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK.

Me 08.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.N.P “Euro Construction” me nr. 922/23 lidhur me aktivitetin “Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc”, me numër të prokurimit 632-23-4357-5-2-1.

Poashtu, për këtë aktivitet të prokurimit OSHP me paraprakisht ka pranuar ankesën 2023/0495 të dt. 18.10.2023.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE N.N.P “Euro Construction” janë parashtruar si në vijim:*

- *Pretendimi i parë (I):* Ka të bëjë me atë se menaxheri i projektit Z. Ismet Berisha ne bazë te dëshmive te ofruara paguhet nga buxheti i Kosovës dhe ka pagë primare te rregullt me nga 40 orë në javë.
- *Pretendimi i parë (II):* Pretendimi i dytë i OE ankues ka te bëjë me pretendimin se OE i rekomanduar për kontratë (TRIANGLE SHPK) nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit sepse ka ofruar si inxhinier Z. Murat Hoxha, dhe dëshmia e ofruar nuk plotëson kërkesën e dosjes se tenderit sepse ky inxhinier ka ofruar dokumentin DIPLOMA te cilin e ka lëshuar shkolla e lartë e gjeodezisë në Beograd. Kërkesa e dosjes se tenderit është qe duhet te ofrohet inxhinieri i diplomuar i Gjeodezisë apo Master i Gjeodezisë dhe jo te prezantohet diploma e shkollës se lartë të Gjeodezisë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE N.N.P “Euro Construction” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1- Qëllimi, nenin 7- Barazia ne Trajtim/Jo diskriminimi, neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Ekzaminimi i Tenderëve, neni 60 -Kriteret për dhënie te kontratës, neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante

lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 20.11.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 922/23, ndërsa me datë 29.11.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0922 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK”.

*Lidhur me pretendimet e OE N.N.P “Euro Construction” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0922 ka vlerësuar si në vijim:*

- *Konstatimi i parë (I):* Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe sqarimet e dërguara nga OE ankues konstatohet se OE Ankues nuk mund të paragjykojë në këtë fazë nëse z. Ismet Berisha në rolin e menaxherit të kontratës do të angazhohet apo jo në këtë projekt me orar të plotë gjatë tërë kohës së ekzekutimit të kontratës. Është detyrë dhe përgjegjësi e AK-Komuna e Gjakovës që gjatë ekzekutimit të kontratës të mbikëqyr kontratën nëse është duke u ekzekutuar në bazë të kushteve të përcaktuara në dosje të tenderit. Po ashtu pas kërkesës për sqarime shtesë nga AK-Komuna e Gjakovës të datës 08.06.2023, operatori ekonomik TRIANGLE shpk ka kthyer sqarimet me datën 12.06.2023 dhe konfirmon angazhimin e Z. Ismet Berisha nëse fitohet kontrata me orar prej 40 orë në javë. I njëjti pretendim ankimor është trajtuar në vendimin e panelit shqyrtues të dt. 16.10.2023 me nr PSH 2023/0495.
- *Konstatimi i dytë (II):* Eksperti konstaton se AK-Komuna e Gjakovës nuk e ka cekur në dosje të tenderit numrin e kredive (pikëve) që duhet të ketë diploma e ofruar për gjeodetin dhe në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me dokumentin e quajtur diplomë dhe kjo konstatohet edhe nga Noteri me rastin e noterzimit të kësaj diplome. Gjeodeti i ofruar nga OE i rekomanduar është po ashtu inxhinier i licencuar nga Agjencia Kadastrale për Kryerjen e Matjeve Kadastrale dhe në bazë të kësaj licence ka të drejtën e kryerjes së punëve kadastrale. Po ashtu sipas nenit 7 të UA 01/2013 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve të nxjerr nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, saktësisht nenit 7 për Licencim të Gjeodeteve saktëson se personi fizik mund të licencohet si gjeodet nëse i plotëson këto kushte. Në bazë të këtij neni 7, paragrafit 1.1 për punët dhe shërbimet e rangut të parë dhe të dytë nga neni 3 i UA 01/2013 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve, gjeodetet licencohen edhe ata që kanë përgatitje profesionale me shkollë të lartë të Gjeodezisë njëjtë sikur ata që kanë përgatitje doktor shkence, Master, BSCH. Bazuar në shkresat e lendes, sqarimet e lartcekura, kërkesat e dosjes së tenderit, konstatohet se ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Konstatohet se operatori ekonomik ankues ka çmimin me të lartë në raport me operatorin tjetër të pa suksesshëm sipas letrës standarde dhe Vendimit të AK-Komuna e Gjakovës të dt. 30.10.2023. Bazuar në përshkrimin e bërë me sipër sipas shkresave të lëndës, raportit të ri vlerësimit, dosjes së tenderit, Vendimit Nr 2023/0495, nenit 6 të Ligjit për prokurim publik, eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së i datës 30.10.2023.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është deklaruar me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave sipas ankesës të dorëzuar me numër protokoll Nr. 922/23 sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Euro Construction” i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues, si dhe pretendimit ankimore nr. 1 të radhitur sipas ekspertizës që kualifikohet si çështje e gjykuar me vendimin e OSHP Nr. 2023/0495, konform nenit 105, paragrafit 2.16 të LPP. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjet e palëve lidhur me raportin e ekspertit dhe përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertave. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë

një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - N.N.P. "EURO CONSTRUCTION"**
- Arkivës së OSHP-së: